



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-038

Prishtinë, më 14 tetor 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 TETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Ismet Mahmuti.

Nga Zyra e Presidentes: Amir Haradinaj,

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për seancë plenare,
2. Sigurimi i hyrjeve në ndërtesën e Kuvendit.

* * *

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 8 tetor 2015, e ka caktuar datën e mbajtjes së seancës plenare më 15 tetor 2015, si dhe rendin e ditës për këtë seancë.

Kryetari foli për situatën e krijuar në Kuvend, pas bllokadës që po i bëjnë deputetët e grupeve parlamentare të opozitës. Ai tha se duhet gjetur zgjidhje për të dalë nga kjo situatë, në mënyrë që Kuvendi t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij kushtetuese.

Ai kërkoi mendimin e nënkryetarëve të Kuvendit dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare se cilat veprimet duhen ndërmarrë për funksionimin normal të Kuvendit. U shtrua dilema për veprimet, si në vijim: a) të përjashtohen nga seanca 30 deputetë të grupeve parlamentare të opozitës, të cilët po e bllokojnë punën e seancës, b) të futen brenda në sallën e seancave pjesëtarët e sigurimit, c) apo duhet ndërmarrë veprime tjera për të krijuar kushte normale për funksionimin e Kuvendit?

Lidhur me çështjen e shtruar nga kryetari i Kuvendit diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Adem Grabovci, kryetar i GP të PDK-së, dhe Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të enjten, më 15 tetor 2015, me fillim në orën 10:00, sipas rendit ditës të caktuar në mbledhjen më pashme.

2. Sigurimi i hyrjes në ndërtesën e Kuvendit

Kryetari e shtroi nevojën për ndërmarrjen e masave shtesë nga pjesëtarët e sigurimit për të kontrolluar të gjithë personat me rastin e hyrjes në ndërtesën e Kuvendit, me qëllim të krijimit të kushteve për punën normale të Kuvendit.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Kryetari i Kuvendit, stafi mbështes politik i kryetarit (këshilltari, vozitësi, truproja, asistenti), nënkryetari i Kuvendit, stafi mbështetës politik i nënkryetarit (këshilltari, vozitësi, asistenti), deputeti, stafi mbështetës politik i deputetit, kryetari i Grupit Parlamentar, stafi mbështetës politik i kryetarit të Grupit Parlamentar (këshilltari, vozitësi, asistenti), Presidentja e Republikës së Kosovës, stafi mbështetës politik i Presidentes (këshilltari, vozitësi, asistenti, truproja), anëtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës, stafi mbështetës politik i anëtarëve të Qeverisë (këshilltari, vozitësi, asistenti, truproja), nëpunësi i Administratës së Kuvendi, gazetarët dhe vizitorët, me rastin e hyrjes në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës obligohen t'i nënshtrohen kontrollit dhe t'u binden urdhrave të pjesëtarëve të sigurimit.
2. Të gjitha bagazhet, duke përfshirë këtu edhe çantat e dorës, i nënshtrohen kontrollit.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale